



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

**Nr. i Dokumentit: 24.29.1-2015-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR PASQYRAT FINANCIARE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT**  
**CIVIL PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015**

**Prishtinë, qershor 2016**

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendos në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Zukë Zuka, i mbështetur nga, Udhëheqësja e Ekipit, Mjellma Dibra Morina dhe anëtare, Refiqe Morina.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	13
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	17
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP .....	18
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	20


## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e muajit tetor 2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

### Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

#### **Opinion i pamodifikuar**

Pasqyrat vjetore financiare *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti varësisht prej llojit të opinionit.

## Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:

Procesi i vetvlerësimit identifikon nevojën për adresimin e duhur të kërkesave lidhur me menaxhimin e rrezikut.



Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se po ndërmerret një rishikim i rregullt i aranzhimeve ekzistuese të qeverisjes duke siguruar se po përmbushen të gjitha kërkesat e MFK-së duke siguruar se është ndërmarrë një analizë e hollësishme e rreziqeve (shih çështjen 1)

## Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm- auditimi 2015

Drejtori ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## 1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.2 Opinioni i Auditimit

### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat vjetore financiare paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, të pranimeve dhe të pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të AAC-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194 si dhe Rregullën financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për pasqyrat vjetore financiare të organizatave buxhetore.

### Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë e tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave buxhetore në Kosovë. ZAP është i pavarur nga AAC dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare**

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare pa anomali materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të AAC-së.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare**

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

AAC kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 03/2014;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 02/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, duke përfshirë raportin e vetvlerësimit;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Pasqyrat financiare nëntëmujore; dhe
- Draft Planin dhe Planin Përfundimtar i prokurimit.

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

Marrë parasysh këtë, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale dhe çështje tjera.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto.

## 1.4 Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.



## 2 Qeverisja

### 2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për AAC-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetëvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

### 2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Dobësitë e identifikuar brenda AAC-së lidhen veçanërisht me menaxhimin e rrezikut. Lista kontrolluese e vetvlerësimit, e plotësuar nga AAC, e pasqyron këtë situatë drejtë, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese që bazohen në dëshmi.

## 2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të AAC-së kanë rezultuar në 9 rekomandime kryesore. AAC kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, shtatë rekomandime janë implementuar dhe dy janë adresuar- në proces të implementimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

---

### Çështja 1 -Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve nga AAC është në funksion të implementimit. Kryesisht rekomandimet e vitit të kaluar kanë të bëjnë për çështje josistematike, megjithatë, dy rekomandime kanë mbetur ende në proces të implementimit.
- Rreziku** Mos implementimi në plotësi i rekomandimeve mund të ketë për pasojë humbjen e mundësisë për përmirësime, vazhdimin e dobësive në sistemin e kontrollit të brendshëm, dhe kjo të ndikojë në arritjen e objektivave të caktuara.
- Rekomandimi 1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të vazhdojë përpjekjet që rekomandimet të cilat janë në proces të implementimit, të jenë të përfunduara në plotësi duke vepruar sipas planit ekzistues të veprimit.

## 2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për AAC-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin Vjetor të Auditimit të ZAP-it. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

### Lista kontrolluese e vetvlerësimit

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponente. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Proceset e vendosjes së objektivave strategjike (përfshirë ndërlidhjen me palët e interesit si dhe sigurimin e strategjisë me kosto të plotë) konsiderohen si të vendosura nga AAC. Dëshmitë në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë adekuate. Çështjet e raportimit janë të vendosura, për më tepër AAC aplikon buletin informativ mujor mbi baza të rregullta.
2. Procedurat për menaxhim të rrezikut janë vendosur në fillim të vitit 2016 megjithëse mungonte një analizë mbi vlerësimin e rrezikut. Një trajtim më i hollësishëm për këtë çështje në nënkapitullin 2.5.1; dhe
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga AAC dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit AAC operon dhe sfidat me të cilat përballet.

## 2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara në MFK kërkojnë që si pjesë e procesit të identifikimit dhe menaxhimit të rrezikut të bëhet edhe një analizë mbi vlerësimin e rrezikut për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik.

---

### Çështja 2 - Kërkesat për Menaxhimin e rrezikut- Prioritet i mesëm

- E gjetura** Pyetësi i vetvlerësimit të plotësuar nga AAC ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut ishin funksionale. Megjithatë, janë ndërmarrë hapa pozitiv në këtë fushë mbetet ende hapësirë për përmirësim. Gjatë vitit 2015 AAC nuk kishte ndërmarrë procesin e identifikimit dhe menaxhimit të rrezikut. Për vitin 2016, AAC ka ndërmarrë hapa në këtë drejtim, megjithatë, nuk shihet se është bërë një analizë e vlerësimit të rrezikut.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë cilësinë e shërbimeve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur.
- Rekomandimi 2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është ndërmarrë një analizë e hollësishme e rreziqeve të identifikuar duke bërë vlerësimin e tyre dhe të reaguarit ndaj këtyre rreziqeve për të ngritur efektivitetin e menaxhimit të rrezikut.

## 2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA-së për themelimin dhe funksionimin e Njësinë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), AAC nuk i plotëson kriteret<sup>1</sup> për themelimin e kësaj njësie. Megjithatë, Departamenti i Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave kishte përfshirë në planin vjetor për 2016 një auditim të rregullsisë<sup>2</sup> në AAC ku fushëveprim kishte vitin 2015. Raporti final ishte pranuar në muajin mars 2016. Raporti ishte përcjell me tri rekomandime në aspektin operativ apo të kontrollit të brendshëm. Menaxhmenti i AAC-së ka ndërmarrë masat për implementimin e këtyre rekomandimeve.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

<sup>1</sup> Buxheti vjetor duhet të jetë mbi një milion euro dhe të ketë mbi 50 të punësuar me orar të plotë.

<sup>2</sup> Objektivat e auditimit: të hyrat, shpenzimet, personeli dhe pasuritë.

---

## 3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

### 3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### 3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket AAC-së, në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat dhe shpenzimet në përgjithësi janë adekuate dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

### 3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për AAC-në, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>3</sup>	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	931,574	839,949	824,472	822,116	729,460
Granti i Qeverisë -Buxheti	924,836	833,211	821,863	822,116	729,460
Donacionet e jashtme <sup>4</sup>	6,738	6,738	2,609	0	0

Në vitin 2015, AAC-ja ka përdorur 98% të buxhet final. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>931,574</b>	<b>839,949</b>	<b>824,472</b>	<b>822,116</b>	<b>729,460</b>
Pagat dhe Mëditjet	677,917	622,979	622,979	594,457	459,035
Mallrat dhe Shërbimet	239,919	208,501	194,482	220,039	258,700
Shërbimet komunale	13,738	8,469	7,011	7,619	11,725

<sup>3</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>4</sup> Donacion nga Komisioni Evropian për projektin Dizajnimi i procedurave të fluturimit përmes sinjalit satelitor

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti në të gjitha kategoritë ishte reduktuar si pasojë e vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore. Me këtë rast buxheti final i AAC-së është 91,625 më i ulët krahasuar me atë fillestar;
- Reduktimi i buxhetit për paga dhe mëditje lidhet me lirimimin e një zyrtari nga pozita e zëvendës drejtorit dhe një zyrtari tjetër që ishte në pushim pa pagesë; dhe
- AAC ka pranuar një donacion të jashtëm në vlerë prej 6,738€ për financimin e projektit “Dizajnimi i procedurave të fluturimit përmes sinjalit satelitor”. Teprica prej 4,129€ bartet për vitin 2016.

**Tabela 3. Të hyrat e mbledhura për buxhetin e Kosovës – ekzekutimi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetanake	1,500,000	1,500,000	1,539,500	1,368,556	1,656,541
Totali	1,500,000	1,500,000	1,539,500	1,368,556	1,656,541

Të hyrat e mbledhura nga AAC nuk shfrytëzohen drejtpërdrejtë por derdhen në Buxhetin e Kosovës (BK).

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### **3.4 Prokurimi**

Gjatë vitit janë nënshkruar 13 kontrata në vlerë prej 58,325€.

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit. Testimi i mostrave lidhur me shpenzimet përmes prokurimit nuk ka identifikuar të gjetura materiale.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

### 3.5.1 Avancet, Komunalitë, Qiraja, etj

Shpenzimet të cilat nuk shkojnë përmes procedurave të prokurimit janë shpenzimet komunale, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet për shërbime të caktuara si arsimi, publikimi, anëtarësimi etj.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. AAC ka kontrolle adekuate në përgatitjen e listave të pagave, siç është verifikimi i ndryshimeve të mundshme si dhe në harmonizimi me Ministrinë e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Financave (MF).

Numri i planifikuar i të punësuarve ishte 28, ndërsa numri aktual 26 me orar të plotë dhe 1 me orar të shkurtuar.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.6 Të Hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Të hyrat e realizuara nga AAC në 2015 ishin në vlerë 1,539,500€. Të hyrat e mbledhura krijohen kryesisht nga të hyrat nga tarifa e Sigurisë së Pasagjerëve që arrin 99% nga totali i të hyrave. Përveç kësaj, inkasohen edhe të hyrat nga tarifat e Certifikimit dhe Licencimit dhe Gjobat tjera. Të hyrat e inkasuara derdhen në buxhetin e konsoliduar. Në testimin e mostrave për inkasimin e të hyrave nuk kemi identifikuar të gjetura materiale.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.7 Pasuritë dhe detyrimet

### 3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrave kontabël të SIMFK për vitin 2015, vlera neto e pasurisë mbi 1,000€ ishte: 3,359€, 12,960€ ato nën 1,000€ dhe stoqet në vlerë prej 3,279€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF-nr. 02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.7.2 Trajtimi i detyrimeve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 2,259€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Të gjitha janë fatura që janë pranuar në muajin dhjetor pas përfundimit të afatit për zotimin e mjeteve.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.



## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### *Forma e opinionit*

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### *Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit*

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
4.2 Qeverisja e mirë	Rekomandimi 1 Drejtori i përgjithshëm i AAC-se të siguroj se kryerja e procesit të vetvlerësimit dhe raportimi është bazuar në gjendjen reale duke e konsideruar si pjesë e përpjekjeve të veta në drejtim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.	Procesi i vetvlerësimit pasqyron gjendjen reale të AAC bazuar në dëshmi bindëse.		
	Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm të konsiderojë që detyrat e Zyrtarit Pasurisë dhe Zyrtarit të Pranimit/Logjistikës duhet të jenë të ndara, dhe të kryhen nga zyrtarë jo të njëjtë.	Rekomandimi është marrë parasysh dhe janë ndërmarrë hapa për adresimin e tij. Detyra e zyrtarit të Pasurisë i është caktuar një zyrtari të AAC-së por që për shkaqe tjera ai ende nuk është certifikuar nga MAP.		
4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Rekomandimi 3 Drejtori i përgjithshëm i AAC-së duhet të sigurojë kontrolle shtesë në kuadër të sektorit të pagesave, në mënyrë që shpenzimet të klasifikohen dhe regjistrohen në përputhje me planin kontabël të miratuar.	Gjatë vitit aktual nuk janë hasur pagesa të cilat nuk ishin klasifikuar drejtë sipas planit kontabël.		

4.4 Të hyrat vetanake	Rekomandimi 4 Drejtori i Përgjithshëm të rishikoj rregulloren duke specifikuar penalitetet dhe normat e interesit të cilat do të aplikohen në rast të vonesës së pagesave.		Rekomandimi është adresuar pasi rregullorja është rishikuar dhe rregullorja e re ka hyrë në fuqi në muajin maj 2015. Edhe përkundër kësaj, ende nuk është implementuar në tërësi pasi janë vërejtur vonesa në pagesa të obligimeve ndaj AAC-së.	
4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Rekomandimi 5 Drejtori i Përgjithshëm të konsideroj nevojat e organizatës për pozitat e përhershme dhe të shqyrtohet mundësia e rekrutimit të rregullt të stafit. Shpenzimet e udhëtimit të mbulohen vetëm për zyrtaret të cilët kanë marrëdhëniet të punësimit të rregullt në këtë institucion.	Gjatë periudhës audituese nuk ka patur raste të tjera me kontratë mbi vepër.		
	Rekomandimi 6 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që avancimet në pozitë janë të arsyeshme, të justifikueshme dhe për qëllim të arritjes së objektivave në pozitat e caktuara. Njëkohësisht, të sigurojë që kjo të ndodhë duke marrë në konsiderim rregullat dhe procedurat përkatëse.	Rekomandimi është marrë parasysh.		
4.6 Pasuritë dhe detyrimet	Rekomandimi 7 Drejtori i Përgjithshëm të sigurohet që janë marrë masa shtesë duke ju përkujtuar poseduesve të pasurisë procedurat dhe kërkesat ligjore për shfrytëzim dhe kthimin e pasurisë.		Nga menaxhmenti i AAC-së janë ndërmarrë masa shtesë por kthimi i pasurisë edhe pas kësaj nuk është bërë.	

	Rekomandimi 8 Drejtori i përgjithshëm i AAC-se duhet të sigurojë se është vë në funksion sistemi e-pasuria dhe se janë bërë gjitha regjistrimet e nevojshme në sistem.	Megjithëse gjatë vitit nuk ka patur blerje të cilat do të duhej të regjistroheshin. Sistemi e-pasuria është funksionale.		
4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm	Rekomandimi 9 Drejtori i Përgjithshëm duhet të konsideroj auditimin e brendshëm përmes NJAB-së tjetër të mundëshme. Në anën tjetër, të rishikoj fushëveprimin e ZABKC-së se ka një plan të realizueshëm dhe efektiv për të arritur objektivat e AAC-së.	Viti fiskal 2015 është audituar nga NjAB e MF-së.		